


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER **JULED A.BEQIRAJ**



Nr. Rep. 1939
Nr. Kol. 1066/1

KONTRATE SHITJE KUOTASH

Sot më datën 25.04.2019, përpara meje Noterit Juled A.Beqiraj, Noter i Dhomes Kombetare te Noterise, Dega Vendore Durrës, në zyrën time në adresën rr. "Egnatia", lagje nr. 4, Durres, u paraqitën personalisht palet si me poshte me cilesine e shitesit dhe te bleresit, te cilet ne baze te nenit 705 e vijues te Kodit Civil si dhe te Ligjit 9901, "Per shoqerite tregtare", te ndryshuar, kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitje si vijon:

SHITESI: Shoqeria "SIAC" sh.p.k. me seli ne Lagja nr.18, rruga "Aleksander Goga", Durres, me nr. NIPT-i J61819503G; e perfaqesuar nga administratori, **Z. AVNI HOXHA**, i biri i Shaban, i dtl. 01.04.1947, lindur ne Durres, dhe banues ne Durres, madhor e me zotesi te plote dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjoftimi nr. 024905556, nr. personal E70401167U;

BLERESIT: 1. Z. RESHARD KELLICI, i biri i Zamir, i dtl. 27.07.1981, lindur ne Shqiperi dhe banues ne Tirane, shtetas amerikan, madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga pasaporta e Shteteve te Bashkuara te Amerikes, nr. 517876667;


2. Z. LUIS HOXHA, i biri i Avni, i dtl. 10.06.1988, lindur ne Tirane, dhe banues ne Durres, madhor e me zotesi te plote dhe per te vepruar, identifikuar nga pasaporta nr. personal I80610092C;

3. Z. LORIN HOXHA, i biri i Avni, i dtl. 27.06.1982, lindur ne Tirane, dhe banues ne Durres, madhor e me zotesi te plote dhe per te vepruar, identifikuar nga pasaporta nr. personal I20627158A;

OBJEKTI: Transferimin e kuotave te shoqerise "**ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC) sh.p.k** ne mbeshtetje te ligjit "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar dhe neneve te Statutit te shoqerise, ne masen 100 % me vlere totale 41.149.928,00 leke (dyzete e nje milion e njeqind e dyzete e nenet mije e nenteqind e njezete e tete) leke, qe i perkasin ortakut te vetem, shoqerise "**SIAC sh.p.k.** ne favor te pales blerese dhe konkretisht te Z. Reshard Kellici (i cili do perfitoje 5 % te kapitalit me vlere 2057496,4 leke), Z. Luis Hoxha (i cili do te perfitoje 70 % te kapitalit me vlere 28804949,6 leke) dhe Z. Lorin Hoxha (i cili do te perfitoje 25 % te kapitalit me vlere 10287482 leke).

Sipas verifikimit te dokumentacionit te paraqitur deri ne ditën e sotme te shoqerise "**ALBANIAN STEVEDORING COMPANY (ASC) sh.p.k** rezulton se kjo shoqeri eshte regjistruar si person juridik me nr. NUIS K92128501U. Aktualisht ortaku i kesaj shoqerie, shoqeria "**SIAC sh.p.k.** posedon 100 % te kapitalit. Pra ne rastin konkret kuorumi i ortakeve eshte i plote.

Objekti i shoqerise eshte: "Ngarkim, shkarkim te mjeteve lundruese dhe aktiviteteve te ngjashme sic jane depozitimi, magazinimi, grupimi, marrja dhe dorezimi I ngarkesave etj. Servis".



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBETARE E NOTEREVE
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER **JULED A. BEQIRAJ****

Kjo shoqeri e ka seline ne Durres, rruga Tregtare, Lagja nr. 1, Porti Detar, prane Zones se Mirembajtjes Mekanike.

Referuar ligjit 129/2014 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin nr. 9901, date 14.4.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar" dhe konkretisht nenit 10 ku thuhet se "Ne rastet e kalimit te kuotave me kontrate, kushtet dhe momenti i kalimit te titullit te pronesise mbi kuoten, si dhe kushtet e tjera te kalimit, perfshire momentin e pageses se çmimit, rregullohen nga kontrata", palet jane dakord qe:

Pronesia 100 % e kapitalit te kesaj shoqerie kalon nga shoqeira "SIAC" sh.p.k. ne favor te pales blerese Z. RESHARD KELLICI, Z. LUIS HOXHA dhe Z. LORIN HOXHA, menjehere me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Pagesa totale ne vleren 41.149.928,00 leke (dyzete e nje milion e njeqind e dyzete e nente mije e nenteqind e njezete e tete) leke, ne favor te ortakut te vetem shoqeria "SIAC" sh.p.k. konsiderohet i likuduar si detyrim qe shoqeria "SIAC" sh.p.k. ka patur ndaj pales blerese.

Me depozotimin e akteve prane QKB-se palet kane detyrimin te paraqesin ekstratin e shoqerise me ndryshimet perkatese ne te gjithë insitucionet dhe organet administrative ku kjo shoqeri ka ushtruar aktivitetin e saj dhe mbart te drejta dhe detyrime.



Kontrata pasi u lexua nga une noteri dhe u gjet sipas vullnetit te paleve nenshkruset vullnetarisht ne prani te noterit nga shitesi dhe bleresi dhe une noteri legalizoj nenshkrimet sipas ligjit.

Kontrates i bashkelidhen dokumentet perberese te saj.

Kontrata u redaktua ne 3 kopje, me nga 1 (nje) faqe, me fuqi te barabarte secila, ku njera prej tyre arkivohet ne kete zyre noteriale.

Shitesi


"SIAC" sh.p.k.

SHOQËRI NDËRTIMESH ITAL O-SHOQIPTARE
L.18. Rr. Aleksandër Goga
DURRËS (SHQIPËRI) tel: 0224107

Bleresit

RESHARD KELLICI



LUIS HOXHA



LORIN HOXHA



NOTER

JULED A. BEQIRAJ

